

PROGRAMI PËRSHPEJTUES NË BUJQËSI &
EKOTURIZEM PËR TË RINJ

ATAR



atar

**Agriculture & Tourism
Accelerator for Youth**

PROGRAMI ATAR

Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ), Akademia SCARDS dhe Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë (UP), ndërmorrën projektin ATAR, projekt ky që inkurajon vetëpunësimin dhe sipërmarrjen midis të rinjve të Kosovës. Qëllimi kryesor i projektit është rritja e punësimit në mesin e të rinjve të papunë dhe përfituesve të ndihmës sociale, duke i fuqizuar ata për të zbatuar idetë e tyre të biznesit në fushat e bujqësisë dhe ekoturizmit të qëndrueshëm.

Në kuadër të këtij projekti, ndërmarrësit e rinj përfituan nga programi i trajnimit, duke bashkëpunuar me pjesëmarrësit e tjerë mbi idetë e tyre të biznesit duke përfituar kështu edhe nga mentorimi i ekspertëve.

Qëllimi kryesor i këtij projekti është identifikimi dhe mbështetja e një ideje biznesi me potencial më të lartë për sukses, që tregon një ndikim të rëndësishëm social, mjedisor dhe ekonomik për një komunitet të caktuar, ose një grup më të gjerë të synuar, që çon në një zhvillim të qëndrueshëm për vetë biznesin.

FAKTE

- Mbi 350 të rinj aplikuan me idetë e tyre për biznes.
- Nga të cilët 82% meshkuj dhe 18% femra.
- Nga të cilët 96% të rinj të papunë dhe 4% përfitues të asistencës sociale.
- Nga të cilë 89% në agrobiznes dhe 11% në ekoturizëm.
- Nga të cilët 4% me shkollim fillor, 35% me shkollim të mesëm dhe 61% me shkollim të lartë.
- 100 nga ta, u trajnuan për menaxhim biznesi
- 25 nga të cilët, përfituan mjete financiare për nisjen e bizneseve.
- Nga 25 biznese të krijuara, momentalisht janë të punësuar 45 persona.


“BLETARI”

Fisnik Demolli udhëheqës i ndërrmarjes biznesore “Bletari” është falenderues ndaj FIQ dhe mbështetjes që ka marrë përmes ATAR. Duke e ditur se si biznes bletaria ka sfida të shumta, të tilla sikur dimri i ashpër apo dhe stimulimi i bletës me ushqim shtesë, Fisniku është i kënaqur me rezultatet e biznesit dhe shpreson që në vijim kushtet atmosferike të jenë më të volitshme.



SHËRBELE & LEVANDË

Agush Bajrami është njëri prej përfituesve të #ATAR me projektin “Kultivimi i shërbelës dhe levandës”. Agushi është tejet i kënaqur me ecurinë e biznesit të tij dhe ka qëllim zgjerimin e tij në muajt në vazhdim.



KULTIVIMI I FASULES NË FORMË VRESHTI

Leonart Gashi ideator i projektit “Kultivimi i fasules në formë vreshti” është falenderues ndaj FIQ dhe projektit #ATAR për suksesin e biznesit të tij. Ai shprehet se biznesi është duke ecur shumë mirë dhe se nga përfitimet e shumta të vitit të kaluar, këtë vit iu është mundësuar rritja e sipërfaqes punuese dhe zhvillimi i formave të tjera të kultivimit të fasules. “Si çdo biznes edhe ne kemi pasur sfida sidomos me prodhimtari për shkak të temperaturave të larta ku rrezik është që fasula mos të riprodhojë fare, por falë eksperiencave tona dhe profesionalitetit si agronom i kemi tejkaluar këto vështirësi dhe rendimentin e kemi të kënaqshëm” thotë Leonarti.



KULTIVIMI I HUDHRËS DHE QEPËS

Ilirdon Rexhepi, një prej përfituesve të projektit #ATAR edhe sot vazhdon punën me biznesin e tij për kultivimin e hudhrës dhe qepës. Pavarësisht sfidës me kushtet klimatike dhe thatësirave të mëdha, Ilirdoni është i kënaqur me suksesin dhe punën e tij.



GJELDETI

Agron Kqiku shprehet se është ndarë tejet i kënaqur me prodhimin dhe cilësinë e produktit të shpeztarisë organike e poashtu edhe me cmimet ne treg. Si sfidë kryesore e këtij biznesi është përhapja e sëmundjeve por ai beson se me anë te profesionalizmit dhe përgjegjësisë së lartë të gjitha sfidat mund të tejkalohen.



KULTIVIMI I ARRËS

Bekë Rexhaj vazhdon kultivimin e arrave pas granitit të fituar në FIQ nga projekti #ATAR. Gjatë punës, ai ka arritur të gjitha objektivat e synuara. Ai dëshiron që të shpërndaj informacionin për përhapjen e arrës pasi që nuk është një kulturë e përhapur në vendin tonë.



NGRITJA E SERRËS ME PERIME

Saranda Musa beson se bujqësia është një nga profesionet më fisnike të njerëzimit. Sipas saj, të punosh tokën, të kultivosh bimët dhe në këtë mënyrë të ushqehesh prej tyre, do të thotë ta duash profesionin që bën.

KULTIVIMI I MJEDRËS

"Kur fillova të lexoja për ATAR, ishte e lehtë të shihja se çfarë ishte një mundësi e madhe për mua dhe për shumë të tjerë. Prandaj, përvojat e mëparshme dhe kënaqësia e takimit me njerëz të rinj dhe shkëmbimi i ideve janë arsyt kryesore përse unë desha të bëhem pjesë e këtij programi." Arbnora Klllokoqi



MJETE TË PUNËS

Përmes këtij projekti do të lehtësohet jetesa në fshat, sidomos për fermerët dhe të gjithë ata që merren me fushën e bujqësisë për të siguruar jetesën. Për momentin jemi duke pritur sezonin për të filluar punën, përderisa jemi në biseda edhe me dy punëtorë të cilët do të angazhohen së shpejti. Rafet Smajli

Forumi për Iniciativa Qytetare

L A G J A P E J T O N , R R . P A S H K O V A S A ,
N R . 1 2 / 1 , 1 0 0 0 0 P R I S H T I N Ë